



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:038533

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844141

K.DH.SHK.II.nr.1042/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi Kryetar i kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri anëtarë, në çështjen juridike të paditësit "The Procter & Gamble Company", me seli në Cincinnati, Ohio, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Naser Peci, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit "Cristal Group Ris", SH.P.K., me NUI: 811900374, me seli në Prishtinë, rruga "Vëllëzërit Fazliu", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Naim Spahiu avokat nga Prishtina, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e te paditurit, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës –Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.2428/22 dt.05.04.2024, me datën 21.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës ""Cristal Group Ris", SH.P.K., me NUI: 811900374, me seli në Prishtinë, rruga "Vëllëzërit Fazliu.

II. VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës –Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.2428/22 dt.05.04.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës –Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike me aktgjykimin e atakuar, KE.nr.2428/22 dt.05.04.2024, ne pjesën e I te dispozitivit te aktgjykimit ka Aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit "The Procter & Gamble Company" dhe Vërtetohet se i padituri "Cristal Group Ris" SH.P.K., përmes importimit të 4000 copë detergjent me shkrimin "ARIEL" me datën 10.08.2022, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit "Ariel Professional" dhe "Ariel Color Activ". Ne piken e II te dispozitivit Urdhërohet shkatërrimi i mallrave të cekura si në pikën I të këtij dispozitivi me shpenzimet e të paditurit, në afat prej shtatë (7) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Ne pien tre (3) te dispozitivit Obligohet i padituri që me shpenzime të tij ta publikoj këtë aktgjykim në dy gazeta të përditshme me tirazh të lartë të Republikës së Kosovës, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimit. Ne piken katër te dispozitivit Detyrohet i padituri që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 425.00 €

(katërqind e njëzet e pesë euro), në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të drejte të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj ankesën e të paditurit si të bazuar, aktgjykimin e goditur ta anuloj dhe çështjen ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Paditësi në përgjigje në ankesë e ka kundërshtuar ankesën si të pabazuar dhe ka propozuar që ankesa e të paditurit të refuzohet si e pathemeltë ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi, ka ushtruar padi kundër së paditurës për shkak të shkeljes së markës tregtare, duke i propozuar që gjykata që kërkesëpadija e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar ashtu që të vërtetohet se i padituri me datën 10.08.2022 me importimin e 4000 thasë detergjent me shkrimin ARIEL, ka shkelur markën tregtare verbale nr.7197 me emër “Ariel Professional” dhe markën tregtare nr. 123 me emër “Ariel Color Activ”; të urdhërohet shkatërrimi i produkteve në fjalë me shpenzimet e të paditurit, të obligohet i padituri që më shpenzime të veta të publikoj aktgjykimin në dy gazeta ditore me tirazh të lartë, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare përmes përfaqësuesit të autorizuar ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke shtuar se e paditura në asnjë formë nuk e ka shkelur markën tregtare të paditësit, pasi që malli i importuar është mall origjinal dhe është importuar nga Turqia shtet në të cilin Republika e Kosovës ka marrëveshjen e tregtisë së lire, andaj baza juridike për shkeljen e markës së të paditurës vërtetohet e kundërta pasi që nga ky vend është importuar ky mall.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancat gjyqësore dhe pas administrimit të provave ka ardhur në përfundim se gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e bazuar për shkaqet si në vijim: Sipas Vendimit nr. KS/2018/1417 i datës 28.02.2018 vërtetohet se paditësi është bartës i të drejtës në markën tregtare verbale “Ariel Professional”, për produktet nga klasa 3 e Klasifikimit të Nicës, dhe atë me vlefshmëri kohore deri më datë 26.05.2028. Nga Ekstrakti nga API lidhur me markën tregtare me nr. të aplikimit KS/R/2008/000488 gjykata vërtetoi faktin se paditësi, është bërthës i markës tregtare verbale “Ariel Color Activ” për produktet nga klasa 3 e Klasifikimit të Nicës, dhe atë me vlefshmëri

kohore deri më datë 27.07.2029. Sipas Listës së Distribuimit - Njoftimit nga Dogana e Kosovës 337-Ariel i datës 11.08.2022, vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit janë ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të drejtës së markave tregtare të paditësit. Nga Deklarata mbi origjinalitetin e produktit të datës 22.08.2022 e lëshuar nga paditësi në gjuhën angleze dhe e përkthyer nga përkthyesi gjyqësor në gjuhën shqipe dhe foto-dokumentacioni i bashkangjitur, gjykata vërtetoi faktin se përfaqësuesja ligjore e paditësit nga Departamenti Ligjor në degën e shtetit të Spanjës, ka konstatuar se mallrat e sekuestruara nga ana e Doganës së Kosovës nuk janë prodhuar nga apo me pëlqimin e pronarit apo ndonjëres prej kompanive që është pjesë e grupit Procter&Gamble”, kjo për faktin se pjesa artistike e produkteve të ekzaminuara ka një sërë gabimesh, të tilla si ikonat e sigurisë AISE apo gabime drejtshkrimore, andaj kanë sugjeruar në shkatërrimin e produkteve të tilla.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles së Dytë, e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Sipas vlerësimit të Kolegjit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles së Dytë, i vlerësoi të paqëndrueshme pretendimet ankimore të paditurit se ne rastin konkret malli është origjinal, për arsye se, sipas nenit 9 par.1 dhe par.2 të Ligjit Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare (LMT) i cili lidhur me të drejtat e fituara nga marka tregtare përcakton se “*Marka e regjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj. Pronari i markës tregtare të regjistruar ka të drejtë të ndalojë të gjitha palët e treta që nuk kanë pëlqimin e tij që ta përdorin atë gjatë afarizmit tregtarë, lidhur me mallra apo shërbime, çfarëdo shenje që: 2.1. është identike me markën tregtare, për mallra ose shërbime që janë identike me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare*” Dispozitat në fjalë, nënkuptojnë se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Rrjedhimisht, bartësi i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme.

Kolegji vlerëson, se me nenin 9 par. 3, nën-par. 3.1 dhe 3.2 të LMT-së përcaktohet se “*Pronari i markës gjithashtu mund të ndalojë këto veprime: 3.1. vendosjen e shenjës në mallra apo në paketimet e tyre; 3.2. futja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje dhe ofrimi i shërbimeve duke përdorur këtë shenjë, ose magazinimi i tyre për këto qëllime; 3.3. importimi apo eksportimi i mallrave me atë shenjë*”.

Nga përmbajtja e dispozitave ligjore të lartcekura kuptohet se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare. Kolegji pajtohet me qëndrimin juridik dhe faktike të gjykatës se shkallës së parë, kur ka aprovuar padinë e paditësit dhe ka konstatuar se nga konfirmimi mbi origjinalitetin i lëshuar nga zyra ligjore e selisë së paditësit në shtetin e Spanjës me datë 22.08.2022, gjykata vërtetoi faktin se mallrat e importuara nga ana e të paditurit, nuk janë prodhuar nga paditësi apo nga një prej kompanive të që është pjesë e grupit të kompanive Procter&Gamble dhe si të tilla janë jo origjinale, sepse nga krahasimet e bëra në mes të mostrës së produktit detergjent Ariel prej 6 kg që prodhohet nga dega e paditësit në Turqi, me mallin e importuar nga ana e padituri po ashtu nga shteti i Turqisë, janë identifikuar dallime në ikonat e sigurisë AISE që pasqyrohen në paketimin e jashtëm të produktit të importuar nga ana e të paditurit si dhe janë identifikuar gabime drejtshkrimore.

Veprimet e tilla të palës së paditur, i japin të drejtë paditësit që t'i ndalojë shkeljen e markës së tij tregtare, andaj në mbështetje të nenit 75 të LMT-së me të cilin parashihet se “*1. Pronari i markës tregtare mund të parashtron padi kundër çdo personi që ka shkelur markën tregtare duke kryer, pa autorizim, ndonjë nga veprimet e përmendura në nenin 9, 10 ose 12 paragrafi 1 të këtij ligji, duke kërkuar: 1.1. konstatimin e shkeljes së të drejtave të markës; 1.2. distancimi nga veprimi i shkeljes, ndalimi i shkeljes së të drejtave dhe ndalimi i vazhdimet të shkeljeve të tilla dhe të ngjashme të të drejtave në të ardhmen*”]

Kolegji ka refuzuar si të pabazuara, pretendimet e të paditurit se paditësi nuk mund të ndalojë importimin e mallrave kontestuese në territorin e Republikës së Kosovës pasi që këto mallra, i padituri i ka blerë nga distributori i autorizuar i paditësit në shtetin e Turqisë me të cilin shteti i Kosovës ka marrëveshje të tregtisë së lirë, e rrjedhimisht paditësit i është ezauruar (shteruar) e drejta në markë tregtare nga neni 14 i LMT-së, edhe kolegji i kësaj gjykate vlerëson si të paqëndrueshme këto pretendime për faktin se në rastin konkret, instituti i “shterimit të së drejtave në markë tregtare” nga neni 14 i LMT-së, mund të vjen në shprehje vetëm në rastet kur produktet që bartin markën tregtare të paditësit, janë prodhuar nga paditësi apo me pëlqimin e tij, dhe këto mallra janë vendosur për shitje nga paditësi në një prej vendeve të përcaktuara me nenin 14 të LMT-së, ashtu që paditësi nuk mund t'i ndalojë rishitjen e mallrave të cilat ai vet i ka prodhuar dhe i ka vënë në tregjet e këtyre shteteve.

Ndërsa në rastin konkret, nga njoftimi i Doganës së Kosovës i datës 10.08.2022 dhe konfirmimi mbi origjinalitetin i datës 22.08.2022 rezulton se mallrat të cilat janë importuar nga i padituri dhe të cilat bartin markën tregtare të paditësit, paraqesin mallra jo origjinale, pra mallra të cilat nuk

janë prodhuar nga paditësi apo një degë e tij, andaj të njëjtat nuk janë vendosur në shitje me pëlqimin e tij. Rrjedhimisht, fakti se i padituri ka sjellë si provë dokumentin noterial nr. 14921 të datës 18.08.2022, ku konstatohet se kompania HAKES GIDA Mad.Iht.Your.Ve.Tic Ltd.Sti prej të cilës i padituri ka importuar mallin kontestues është distributor i produkteve të paditësit në territorin e Turqisë, nuk i bën mallrat e importuara nga i padituri në Republikën e Kosovës si mallra origjinale, pasi që origjinalitetin e produktit mund ta konfirmoj vetëm prodhuesi i tij, në këtë rast paditësi. Kësisoj, blerja e mallrave jo origjinale nga i padituri prej distributorit të paditësit në shtetin e Turqisë, nuk mund t'a liroj palën e paditur nga përgjegjësia për shkeljen e markës tregtare të paditësit, por që kjo rrethanë mund t'i krijoj shkas për të paditurin që të inicioj procedurë gjyqësore ndaj eksportuesit prej të cilit ka blerë mallrat në fjalë.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj sipas të LMT-së, përbën shkelje të markës tregtare. Shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëjën prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se i padituri ka importuar 4000 thasë detergjent me shkrimin ARIEL pa autorizimin e paditësit si bartës i te drejtave nga marka tregtare e regjistruar "Mercede-Benz". Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, fakti se mallrat janë origjinale ose jo, nuk përbën fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare. Bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të markës tregtare.

Prandaj duke u nisur nga të sipër cekurat Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se i padituri me importimin e mallrave kontestuese dhe vënien e tyre në treg e ka shkelur markën tregtare të paditësit dhe në këtë kuptim vlerëson 75 të LMT-së me të cilin parashihet se *"1. Pronari i markës tregtare mund të parashtron padi kundër çdo personi që ka shkelur markën tregtare duke kryer, pa autorizim, ndonjë nga veprimet e përmendura në nenin 9, 10 ose 12 paragrafi 1 të këtij ligji, duke kërkuar: 1.1. konstatimin e shkeljes së të drejtave të markës; 1.2. distancimi nga veprimi i shkeljes, ndalimi i shkeljes së të drejtave dhe ndalimi i vazhdimit të shkeljeve të tilla dhe të ngjashme të të drejtave në të ardhmen"*, sepse në produktet e të paditurit janë përdorur shenjat identike me markat tregtare të paditësit. Andaj edhe kjo gjykatë konsideron në rastin konkret, vendimi i gjykatës së shkallës së parë për shkatërrimin e produkteve kontestuese është në proporcion të plotë me shkeljen e të paditurës.

Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur kur, ka refuzuar lejimin e paraqitjes së kundërpadisë kompensuese nga ana e të paditurës, kjo për faktin se në rastin konkret, padia e paditësit ka pasur si kërkesë vërtetimin e shkeljes së markës tregtare dhe ndalimin e shkeljes së saj në të ardhmen por nuk ka pasur si kërkesë të hollat apo sendet e tjera të zëvendësueshme. Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk është plotësuar kushti nga neni 256 par (b) i LPK-së për paraqitjen e kundërpadisë kompensuese, pasi që kërkesat e paraqitura në padi nuk mund të kompensohen me kërkesat të cilat i padituri i ka paraqitur me kundërpadi.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles së Dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë,
K.DH.SHK.II.II.nr.1042/24, dt.21.06.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi d.v.